



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 437/16 prot.

Datë 05.03.2026

V E N D I M
Nr. 353/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Liqeni VII” Shpk në procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastrë”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e BOE “O.B.Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga BOE “LIS Konstruksion” Shpk & “Viante Konstruksion” Shpk, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Liqeni VII” Shpk, me NIPT K01730502W dhe adresë: Rruga "Dituria", Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës.

BOE "LIS Konstruktion" Shpk (përfaqësues) me NIPT K66613407H, dhe me adresë: Bulqize, Lagjia Minatori, Rruga e Spitalit, Pallati nr.12, Shk.1, Kati 5, Ap.15 & "Viante Konstruktion" SHPK me NIPT K47103804L.

Subjekt i interesuar: BOE "O.B.Konstruktion" SHPK (përfaqësues) me NIPT K93728201A dhe adresë: KRUJE, Qendër Krujë, Lagjia Nr.1. & "ED Konstruktion" Shpk.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujës-jellës Kanalizime Gjirrokastër Sh.a. me adresë: Rr.Muharrem Gega "Nd.24, Hyrj. 1, Gjirrokastër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *"Për Prokurimin Publik"*, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"*, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *"Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *"Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 *"Për prokurimin publik"* i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik, i ndryshuar.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

1.5. Operatorët ekonomikë ankimues kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 11.11.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastrë”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a.

II.2. Në datën 11.12.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Në datën 02.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. BOE DESARET COMPANY & AURORA CONTRUCTION 80,089,403.39 I Skualifikuar
2. BOE NDREGJONI & RAFIN COMPANY 87,854,937 I Skualifikuar
3. BOE ERAL CONSTRUCTION & STERKAJ 88,467,811.1 I Skualifikuar
4. BOE AGI KONS & NDERTIMI SHPK 90,422,898.36 I Skualifikuar
5. ZDRAVA 98,462,741.34 I Skualifikuar
6. BOE SHKELQIMI 07 & GRAND KONSTRUKSION M 100,000,000 I Skualifikuar
7. HASTOCI 104,783,327.22 I Skualifikuar
8. BOE MANE’S &NIKA 107,658,963.12 I Skualifikuar
9. BOE K.M.K & CAUSHI M 108,024,938 I Skualifikuar
10. LIQENI VII 108,261,678.89 I Skualifikuar
11. BOE LIS KONSTRUKSION & VIANTE KONSTRUKSION 110,048,112.16 I Skualifikuar
12. BOE ERGI & BE-IS SHPK 111,335,158 I Skualifikuar
13. BOE OB KONSTRUKSION & ED KONSTRUKSION 115,448,500 I Kualifikuar
14. SHENDELLI 128,374,342 I Skualifikuar

II.4. Në datën 04.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Formular Njoftim – Fituesi paraprak”, për procedurën e prokurimit dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike nr. 13, datë 19.02.2026, ku është shpallur fitues BOE OB KONSTRUKSION & ED KONSTRUKSION.

II.5. Operatori ekonomik “ LIQENI VII Shpk”, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

“Në vlerësim të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik për këtë procedurë prokurimi në plotësim të kërkesave të AK konkretisht:

në vlerësim të dokumentacionit, konkretisht ofertës ekonomike të paraqitur nga operatori ekonomik rezulton se ka përllogaritur gabim lidhur me paisjet e preventivit, duke i llogaritur me tvsh.

Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga OE, konstatohet, se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, duke e shoqëruar këtë edhe me analizën e çmimeve përkatëse siç janë kërkuar në këto dokumente.

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I Udhëzime për operatorët ekonomikë PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar” ndërsa në pikën 6 “Çmimet” është përcaktuar se: “Ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës”

KVO sa më sipër analizuar, gjykon, se autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, hartimi i dokumenteve të tenderit dhe zhvillimi i procedurës së prokurimit është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt-prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejte me kriteret e vendosura në dokumentet e tenderit dhe hapat që duhet të ndiqen për përzgjedhjen e ofertës më të mirë, në kuptim të këtij ligji.

KVO konstaton, se duke u kthyer tek dokumentacioni i paraqitur në lidhje me vlerësimin e procedurës së prokurimit objektshqyrtimi, në kuadër të shqyrtimit administrativ në mënyrë sa më transparente dhe të drejtë në zbatim UKM nr. 3 struktura e preventivit jepet në shtojcën bashkalidhur këtij udhëzimi dhe konkretisht: Nr. Nr. Analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlera Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Për sa paraqitëm më lart punimet e ndërtimit dhe ato teknologjike dhe të montimit janë pjesë e shpenzimeve të drejtpërdrejta të cilave ju shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së.

Nga sa më sipër pasqyruam rezulton, se preventivi i paraqitur nga ana e BOE është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, “Në

rubrikën dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka vënë në dispozicion të operatorëve ekonomikë dokumentin me emërtimin:

Preventiv pa çmime. Format i vënë në dispozicion është përdorur nga operatori ekonomik ankimes për plotësimin e ofertës ekonomike

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KVO konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim pajisje . Gjithashtu, edhe nga përcaktimet e bëra në shtojcën 1 nga ana e autoritetit kontraktor nuk konstatojmë se ka paqartësi ç'ka mund të ndikonte tek operatorët ekonomikë gjatë plotësimit të kësaj shtojce.

KVO konstaton, se ndodhemi në kushtet e mospërputhjes së shumës së ofertës ME TVSH të pasqyruar në formularin e ofertës, me përllogaritjen e shumave të pasqyruara në preventivin përkatës, përkatësisht Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) të ofruar në preventiv me ato të ofruara në formularin e ofertës. Mospërputhja vjen si rrjedhojë e mospërllogaritjes të vlerës së pajisjeve në totalin pa tvsh.

Pra BOE në ofertën me TVSH të deklaruar në formularin e ofertës nuk e ka deklaruar shumën e pajisjeve, pasi sipas përllogaritjes së shumave në tabelën përmbledhëse të preventivit oferta totale me TVSH e deklaruar në formularin e ofertës duhet të ishte Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) = Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) + Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje).

Komisioni gjykon, se BOE ndodhet në kushtet e përllogaritjes së ofertës ekonomike në kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe në mënyrë jotransparente, pasi referuar formularit tip të përcaktuar në Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, dhe oferta ekonomike me TVSH duhet të ishte përllogaritur si më poshtë vijon: Nr. Nr. i analizës Emërtimi i punimeve Njësia Sasia Çmimi Vlefë Shuma TVSH Shuma Pajisje Shuma Referuar formularit të ofertës

Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimes ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhet përllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur 105,881,278.89 + tvsh = 127, 057 ,534,6 dhe duke shtuar vlerën e shumës pajisje në vlerën 2,380,400 = 129,437,934.6 dhe jo 129,914,014.67 me tvsh, Në rastin konkret KVO gjykon, se si autoriteti kontraktor ashtu edhe BOE shfaqet në cilësinë e tatimpaguesit të cilët në transaksionet financiare midis tyre zbatojnë lex specialis, ligjin në fuqi për procedurat tatimore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar.

Operatori ekonomik ka përllogaritur gabim vlerën me tvsh të ofertës, duke përfshirë në tvsh dhe pajisjet. Komisioni për raste të ngjashme i është referuar vendimit Nr.1217/2022 të Komisionit të Prokurimit Publik.

Operatori ekonomik nuk ploteson kriteret e kualifikimit pasi nuk ka paraqitur nje automakinist nga 2 dy te kerkuar ne kriteret e kualifikimit.

Operatori ndodhet ne kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundërshtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”

Përlllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik .

Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, **mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE”.**

II.5.1. Në datën **11.02.2026 nëpërmjet shërbimit postar**, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 437/2026 protokolli, datë 11.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6313 e OE “Liqeni VII” Shpk, e cila rezulton me statusin e paguar mandat pagesa, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori BOE “O.B.Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.5.2. Në datën **11.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike** pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 437/1/2026 protokolli, datë 12.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6319 e OE “Liqeni VII” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj është i njëjti me formular ankesën e dërguar me shërbim postar, me statusin e paparaqitur mandat pagesa.

II.5.3. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 437/2 prot., datë 12.02.2026, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori BOE “O.B.Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 437/1/2026 prot., datë 12.02.2026.

II.5.3. Nëpërmjet shkresës me objekt “Kërkesë” me datë 12.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/3 prot., datë 13.02.2026, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues kërkesa mbi bashkim aplikimesh dhe njohje mandat pagese.

II.5.4. Nëpërmjet shkresës me objekt “Kërkesë” me datë 12.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/4 prot., datë 16.02.2026, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues kërkesa mbi bashkim aplikimesh dhe njohje mandat pagese, duke i bashkëlidhur edhe prova si dhe komunikime me institucionet përgjegjëse për administrimin e sistemit të SPE dhe SAE si dhe AK.

II.5.5. Nëpërmjet shkresës me datë 11.02.2026, ora 22:00, protokolluar me tonën me nr. 437/5 prot., datë 16.02.2026, me objekt “*Informacion*”, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues, informacioni mbi depozitimin dhe aplikimin me sukses nga webi i sistemit elektronik të ankesave (SAE), të formulart të tij të ankesës me nr. Elektronik A/2026/6319 të datës 11.02.2026.

II.5.6. Nëpërmjet shkresës me datë 16.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/6 prot., datë 19.02.2026, me objekt “*Informacion*”, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues, informacioni mbi depozitimin dhe aplikimin me sukses nga webi i sistemit elektronik të ankesave (SAE), të formulart të tij të ankesës me nr. Elektronik A/2026/6319 të datës 11.02.2026 dhe komunikime me institucionet përgjegjëse për administrimin e sistemit të SPE dhe SAE si dhe AK, të dokumentuara me prova.

II.5.7. Nëpërmjet shkresës me datë 19.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/7 prot., datë 19.02.2026, me objekt “*Informacion*”, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues, informacioni mbi depozitimin dhe aplikimin me sukses nga webi i sistemit elektronik të ankesave (SAE), të formulart të tij të ankesës me nr. Elektronik A/2026/6319 të datës 11.02.2026 dhe komunikime me institucionet përgjegjëse për administrimin e sistemit të SPE dhe SAE si dhe AK, të dokumentuara me prova.

II.5.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 1409/1 prot., datë 20.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/8 prot., datë 23.02.2026, ku Agjencia e Prokurimit Publik ka vënë për dijeni Komisionin e Prokurimit Publik mbi problematikën e statusit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, për të cilën i ka kthyer përgjigje edhe OE ankimues “Liqeni VII” Shpk.

II.5.9. Me shkresën me nr. 437/9 prot., datë 24.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik iu drejtua me kërkesë autoritetit kontraktor, që të dërgoi brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave, të jepen argumentimet përkatëse mbi pretendimet e operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHPK si dhe vendimin e autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II.5.10. Nëpërmjet shkresës me nr. 355/1 prot., datë 20.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/10 prot., datë 25.02.2026, me objekt “Vendimi i KSHA”, dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së OE ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.5.11. Nëpërmjet shkresës me datë 27.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/11 prot., datë 02.03.2026, me objekt “Argumenta”, është depozituar nga operatori ekonomik ankimues parashtrime shtesë.

II.5.12. Nëpërmjet aplikimit online, nga ana e OE ankimues është dërguar Formulari i Argumentave, protokolluar me tonën me nr. 437/12 prot., datë 02.03.2026.

II.5.13. Nëpërmjet shkresës me nr. 448/1 prot., datë 27.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 437/13 prot., datë 03.03.2026, autoriteti kontraktor ka dërguar shkresën me me objekt “Kthim përgjigje”.

II.6. BOE “LIS Konstruksion” Shpk &” Viante Konstruksion” Shpk”, rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit për arsyet si më poshtë:

““BOE ndodhet ne kushtet e perlllogaritjes gabim se ofertes ekonomike ne kundershtim me parashikimet e akteve ligjore dhe nenligjore ne fuqi ne kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” Përllogaritja duke i zbritur TVSH-në paisjeve dhe më pas llogaritjen e TVSH-së përsëri në ofertën totale me TVSH, shkakton një ofertë ekonomike pa TVSH jo reale, cka do të favorizonte në mënyrë të padrejtë operatorin ekonomik . Komisioni gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka vepruar në kundërshtim me ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrit të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH” dhe Udhëzimin nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr.3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pasi vlera ofertës me TVSh duhej përllogaritur Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%) pa TVSh + tvsh e këtyre zërave, që sipas vlerave të preventivit të paraqitur $108,788,012.16 + tvsh = 130,545,614.6 + paisje\ 1,260,100 = 131,805,714$ lek me tvsh Nga detajimi i ofertes ekonomike ne shtojcen nr.2 rezulton se oferta ekonomike me tvsh eshte parqitur nga ana e operatorit ekonomik ne vleren $132,057,734.6$ leke me tvsh, duke futur ne vleren e tvsh edhe pajisjet te cilat nuk i bashkohen tvsh qe marrin punimet civile. Perlllogaritja e bere nga operatori ekonomik sjell nje oferte ekonomike jo reale cka do te favorizonte ne menyre te padrejte operatorin ekonomik në klasifikimin përfundimtar të ofertave, të procedurës prokurimit Në këto, **mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim, për refuzimin e ofertës të OE .**

Nuk ploteson kriterin mbi autorizimet , kataloget e saraqinesave dhe rakorderive jane ne gjuhe te huaj jo shqip gje e cila bie ne kundeshitim me dokumentacionin e tenderit pika me piken 4.7 ne dokumentat standarte te tenderit ku percaktohet se : 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X Anglisht Komisioni i vleresimit te ofertave per sa me siper gjykon dhe analizon se BOE LIS KONSTRUKSION shpk& Viante Konstruksion shpk ka mungese dokumentacioni dhe shkelje te kritereve te hartuara ne DST per kete arsye skualifikohet”.

II.6.1. Në datën 11.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6315 dhe nr.443/2026 prot, datë 11.02.2026 i operatorit ekonomik BOE “LIS Konstruksion” Shpk &” Viante Konstruksion” Shpk, për procedurën e prokurimit, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së BOE ankimues.

II.6.2. Bazuar në nenin 112, pika 3, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr. 443/1 prot., datë 12.02.2026, lidhur me arsyet e skualifikimit të BOE “LIS Konstruksion” Shpk &” Viante Konstruksion” Shpk, që kundërshton me anë të ankesës me nr. 443/2026 prot., datë 11.02.2026.

II.6.3. Nëpërmjet shkresës me nr. 354/3 prot., datë 20.02.2026, protokolluar me tonën me nr. 443/2 prot., datë 25.02.2026, me objekt “Njoftim KPP”, dërguar me shërbim postar, është depozituar nga autoriteti kontraktor informacioni mbi trajtimin e ankesës së BOE ankimues, ku konstatohet, se e ka **refuzuar** atë.

II.7. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor dhe verifikimeve të kryera,

Arsyeton:

III. Në datën **11.02.2026 nëpërmjet shërbimit postar**, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 437/2026 protokolli, datë 11.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6313 e OE “Liqeni VII” Shpk, e cila rezulton me statusin e paguar mandat pagesa, ku u konstatua, se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik ankimues, si dhe vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori BOE “O.B.Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” Shpk, në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit. Në datën **11.02.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike** pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 437/1/2026 protokolli, datë 12.02.2026 dhe me numër ankimi elektronik A/2026/6319 e OE “Liqeni VII” SHPK, ku u konstatua, se objekti i saj është i njëjti me formular ankesën e dërguar me shërbim postar, me statusin e paparaqitur mandat pagesa. Në kushtet kur, OE ankimues ka paraqitur prova mbi mosfunksionimin e sistemit për të ngarkuar formularin e ankesës për procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe komunikime me institucionet përgjegjëse për administrimin e sistemit të SPE, SAE, AK, si dhe këto dy formularë ankesash të dorëzuara brenda së njëjtës datë dhe me të njëjtin objekt ankesë, Komisioni do të marrë në shqyrtim pretendimet dhe ankesën e OE “Liqeni VII” Shpk, dhe mandat pagesa e paguar brenda afatit nga ana e ankimues vlen për të dyja formularët ankesave, në kushtet kur jemi në të njëjtën procedurë prokurimi dhe me të njëjtin objekt pretendimesh.

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 2 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatorit ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerëdo të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.1.2. Autoritetit kontraktor ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit në rubrikën “Dokumentat e tenderit” preventiv pa cmime me përmbajtje si më poshtë vijon:

		28. PAJISJE JASHTË LISTE				
440	Pj	Impiant klorifikimi >	copë	1.0		
441	Pj	Cisterne dhe depo PE 80 l >	copë	1.0		
442	Pj	Cisterne dhe depo PE 125 l >	copë	1.0		
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	29.8046 66		
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100.0		
445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244.0		
446	Pj	F.V. Mates Uji Elektromagnetik DN=PN16 >	copë	3.0		
		Shuma 28:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Preventivuesi:

C.E.C GROUP

Investitori:

AKUK

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Liqeni VII” Shpk, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular i ofertës ekonomike sipas formatit shtojca 1 dhe shtojca 2 të DT;

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të

zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.1.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Vendim Nr. 610, Datë 22.9.2022 “Për Përcaktimin E Rregullave Të Detajuara Për Mënyrën E Caktimit Të Mbikëqyrësit, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Tij, Kushtet Dhe Elementet E Përgjithshme Të Sigurimit Të Përgjegjësisë Profesionale, Si Dhe Rregullat, Procedurat Dhe Mënyrën E Mbajtjes Së Dokumentacionit Gjatë Zhvillimit Të Punimeve”, në Shtojcën XII të tij pasqyrohet:

OBJEKTI: “ _____ ”

ZBATUESI I PUNIMEVE: “ _____ ” sh.p.k.

Datë: ____/____/____	Nr.	Nr. i analizës	Emërtimi i punimeve të kryera	Njesia	Sasia e punimeve të kryera	Çmimi	Vlefë
Shuma e analizave							
Fondi rezervë deri në 5%							
(vendoset në situacionin përfundimtar në % e përdorur)							
Shuma (Analiza+fondi rezervë)							
TVSH							
Pajisje							
Totali							

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, në nenin 5 të tij parashikon se: “Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit..”.

Ndërsa në Nenin 6, 7 dhe 18 të tij *parashikon* :6. *“Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”.*

7. *Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.*

18. *Të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.*

III.1.7. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai bazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, bazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.1.8. Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga ankimuesi, konstatohet se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim i pajisjeve me dhe pa TVSH. Tabela e preventivit ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e

autoritetit kontraktor është si më poshtë, e cila është edhe arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankmiues:

Seriali: 14DF3C46-991D-4A40-82A6-A6D21F8C00D6

		28. PAJISJE JASHTË LISTE				
440	Pj	Impiant klorifikimi >	copë	1.0		
441	Pj	Cisterne dhe depo PE 80 l >	copë	1.0		
442	Pj	Cisterne dhe depo PE 125 l >	copë	1.0		
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	29.8046 66		
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100.0		
445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244.0		
446	Pj	F.V. Mates Uji Elektromagnetik DN=PN16 >	copë	3.0		
		Shuma 28:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Preventivuesi:
C.E.C GROUP

Investitori:
AKUK

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I, Udhëzime për operatorët ekonomikë, gërma B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqëruar duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar [...]*”. Konstatohet se, preventivi i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankmiues është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankmiues ka dorëzuar preventivin të plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të autoritetit kontraktor. Nisur nga aryesja e skualifikimit të cituar në raport auditi nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave si dhe arsyetimit të dhënë në informacionin e dërguar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni i Prokurimit konstaton se, në plotësimin e formularit të

ofertës ekonomike nga ana e ofertuesit “Liqeni VII” Shpk sipas formatit shtojca 1 dhe shtojca 2 e DT:

28. PAJISJE JASHTË LISTE					
440	Pj	Implant klorifikimi >	copë	1.00	
441	Pj	Cisternë dhe depo PE 80 l >	copë	1.00	
442	Pj	Cisternë dhe depo PE 125 l >	copë	1.00	
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	30.00	
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100.00	



445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244.00	4,600.00	
446	Pj	F.V. Mates Uji ElektromagnetikDN=PN16 >	copë	3.00	150,000.00	
Shuma 28:						
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Per "LIQENI VII" sh.p.k

Musa Kalla

Administrator

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehën në Monedhën Leke (e kërkuar në dokumentat e tenderit)



Së pari, operatori ekonomik ankimues ka plotësuar në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar dhe hartuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Së dyti, në kapitullin e preventivit “28. Pajisje jashtë liste”, konkretisht zërat Pajisje, ofertuesi ka dhënë çmimin pa tvsh për njësi/copë * sasia /copë = X vlera/çmimi total lekë pa

tvsh për cdo zë të pajisjeve. Pra, për sa i përket strukturës së preventivit, referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe Manualit të Përdorimit të këtij sistemi në e-albania, për pajisje jashtë liste, sistemi jep dy alternativa (0% ose 20%), ndërsa për pajisje nga lista aplikohet automatikisht 20%. Për këtë arsye, preventivi i hartuar nga projektuesi, duhet të ishte më i qartë dhe i shoqëruar me sqarime të detajuara duke vënë në dijeni edhe autoritetin kontraktor, se cilin konfigurim ka zgjedhur projektuesi për pajisje jashtë liste.

III.1.7. Megjithatë, në rastin konkret, për një shqyrtim të drejtë të pretendimit të operatorit ekonomik ankimues nga njëra anë si edhe parashtimeve të autoritetit kontraktor nga ana tjetër, KPP gjykon të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të sipërcituar, mbi gabime të mundshme në përlllogaritjen e ofertës ekonomike si vlerë totale e kërkuar pa shtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për kryerjen e punimeve në total. Referuar tabelës përmbledhëse të formularit të ofertës, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi, Punime Elektrike, Punime Instalimi (Hidrosanitatë, ngrohje, mbr nga zjarri), punime montimi paisje, si edhe furnizim i paisjeve me TVSH. Në pikën 3 “Modalitetet dhe mënyra e zbatimit të TVSH-së në ndërtim të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, pargrafët 1,4 parashikohet se: *“Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike (rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial.TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata: a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm; b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm. Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull*

ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH ja sipas ligjit. Përse i përket pikës 4, rasti b), ku objekti që ndërtohet do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm, për shembull ndërtohet një magazinë që personi i tatueshëm e përdor për magazinimin e mallrave për t'u shitur, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do t'i shërbejë një veprimtarie nga e cila lindin pagesa të TVSH-së.”

III.1.8. Në rastin konkret, KPP gjykon se në cilësinë e personit të tatueshëm ndërtues, operatori ekonomik ankimues ka përllogaritur koston ekonomike të ofertës së tij duke përfshirë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi dhe veçanërisht detyrimet dhe rregullimet e kreditimit/zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar rikonstruksion i një objekti (furnizimi me ujë) që do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma “a” të pikës 3 “Modalitetet dhe mënyra e e zbatimit të TVSH-së në ndërtim të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, parashikohet se “Përse i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.”

Në rastin konkret, KPP gjykon se, në përlllogaritjen e vlerës ekonomike operatori ekonomik ankimues ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH. Në respekt të udhëzimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor, në cilësinë e tatimpagesit investitor ka parashikuar në formularin e ofertës se për kapitullin “Pajisje jashtë liste” nuk tatohet dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për sa kohë që, pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohej me vlerën e tyre, konkretisht çmimin pa tvsh për njësi/copë * sasia /copë = X vlere/çmimi total lekë pa tvsh për çdo zë të pajisjeve, sipas strukturës së preventivit të zgjedhur nga projektuesi dhe të miratuar dhe publikuar nga vetë autoriteti kontraktor, i cili nuk ka dhënë asnjë sqarim përkatës në lidhje me metodologjinë e plotësimit, rezultojnë që, zërat e pajisjeve jashtë liste për kapitullin “28. Pajisje jashtë liste”, nuk kanë të përfshirë në çmimin për njësi, vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Në parashtrimet që bënë OE ankimues në formularin e ankesës, ka sqaruar se, nuk do të importojë pajisje nga jashtë por, do të blihen në tregun vendas, ku në furnizimet vendase, Tvsh aplikohet normalisht sipas ligjit për Tvsh dhe rimbursimi i saj do të bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në fund viti, kur bëhet edhe rimbursimi i Tvsh, në bazë të faturave tatimore elektronike sipas sistemi të fiskalizimit nga blerësi. Në përfundim, nga përlllogaritjet e veprimeve aritmetike të formularit të ofertës ekonomike të OE ankimues, Komisioni konkludon se, plotësimi i saj është bërë sipas strukturës së preventivit të shtojcës 2 të DT dhe në përputhje të plotë me aktet nënligjore në fuqi referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe Manualit të Përdorimit të këtij sistemi në e-albania. Atëherë, në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlere totale e tyre e paisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike me TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përlllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike, operatori ekonomik ankimues, ka plotësuar të gjitha rubrikat e vendosura në hartimin e strukturës së preventivit, si dhe nga kontrolli i veprimeve matematikore, Komisionit konstaton se, nuk jemi në rastin e ndonjë gabimi aritmetik qoftë në shumëzimin apo edhe në mbledhjen aritmetike të vlerave financiare apo në aplikim dy herë të Tvsh për pajisjet jashtë liste. Pra, referuar edhe mënyrës së plotësimit të të gjithë rubrikave të preventivit si dhe vlerave financiare të ofertës ekonomike nga ana ofertuesit ankimues, është konform asaj të kërkuara nga ana e AK dhe brenda kuadrit ligjor të përlllogaritje së vlerës mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për më tepër, referuar edhe argumentimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke marrë si referencë një vendim të KPP_së i cili daton në vitin 2022, vit i cili akoma nuk ishte implementuar sistemi i informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim, si dhe hartimi në e-albania të preventivit nga projektuesi, i cili bie ndesh me kuadrin ligjor të përditësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Sa më sipër, KPP gjykon se në përgatitjen e ofertës ekonomike nga ana e operatorit ekonomik ankimues pretendimi i mësipërm i autoritetit kontraktor nuk përfshihet në rastet e konstatimit të gabimit aritmetik, por njëherazi në përlllogaritjen e ofertës nga ana e ankimuesit nuk shfaqen gabime në drejtim të ndërtimit të ofertës ekonomike dhe vlerës totale të saj me dhe pa TVSH duke mos rënë ndesh me parashikimet dhe rregullimet e posaçme ligjore në legjislacionin sektorial tatimor. Në përfundim të analizës së sipërcituar, autoriteti

kontraktor duhet të kthejë procedurën e prokurimit në fazë të rivlerësimit dhe të kryejë rivlerësim të ofertës ekonomike të operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII shpk”, duke i reflektuar këto veprime me anë të dokumentacionit përkatës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....Operatori ekonomik nuk plotëson kriteret e kualifikimit pasi nuk ka paraqitur një automakinist nga 2 dy të kërkuar në kriteret e kualifikimit.....”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në pikën 2.3.3. “Kapaciteti teknik”, të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE, është parashikuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon:

”2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe çertifikimet përkatëse, si më poshtë:

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- **5 (pese) Manovratorë /2(dy) Eskavatoristë /2(dy)Automakinist/1(një) Buldozierist**, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

Për secilin pjesëtar të stafit të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune / shërbimi të vlefshme; Dëshmi e aftësisë profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda të ndërtimit dhe punimeve në tokë (të vlefshme) lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor; Kartela personale të sigurimit teknik të vlefshme të lëshuara të lëshuara nga institucione shtetërore ose nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve.

(Në rastin kur punonjësit eskavatorist, automakinist dhe shofer janë të kontraktuar me kontratë pune (respektivisht për mjetet e marra me qera), nuk kërkohet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë).

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr.8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe nga dokumentacioni fizik i dorëzuar në formë shkresore pranë autoritetit kontraktor rezulton, se OE ankimues “Liqeni VII”, në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar:

-Formular Përmbledhës Vetëdeklarimi me datë 11.12.2025;

B: DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time se: Unë kam punonjës të nevojshëm siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar, nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.	Punonjës Po [X] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve : Numri i punonjësve për muajt Gusht 2025 - 56 Punonjes Shtator 2025 - 58 Punonjes Tetor 2025 – 61 punonjes. Gjithashtu, disponoj personelin kryesor të poshtëshënuar, sipas profileve (profesioneve/kualifikimeve) përkatëse:

	38. Z.Ej. Mc me profesion automakinist, i punësuar pranë shoqërisë sone, në rolin e Automakinistit . Nr Kontrate: Kontrate midis paleve date 17.07.2025. me Nr. Dëshmie DM- Date 11.01.2024 e vlefshme deri me Date 10.01.2029 leshaur nga DPSHTRR
	43. Z.Aj. Sh me profesion Automakinist, i punësuar pranë shoqërisë , në rolin e Automakinistit për shoqërisë me targa Nr Kontrate: Kontrate midis paleve date 08.01.2024. me Nr. Dëshmie DM- vlefshme deri me Date 18.03.2030 leshaur nga DPSHTRR

III.2.3. Në nenin 77 pika 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- aftësinë teknike dhe profesionale.*

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.2.4. Në nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet;

1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

3. Pavarësisht pikës 2 të këtij neni, operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër i ka këto dokumente.

4. Në rastin e operatorëve ekonomikë të huaj, dokumentet duhet të paraqiten në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit. Në raste të dokumenteve që nuk lëshohen në vendin e origjinës, ky fakt duhet të provohet prej operatorëve ekonomikë.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë:

a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

b) dokumentet mbështetëse në origjinal ose një kopje të noterizuar të tyre për vetëdeklarimet e dhëna.

Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni, sipas shkronjave “a” dhe “b” të kësaj pike, u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.”.

6. Për operatorët ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë, krijimi dhe plotësimi i formularit përmbledhës të vetëdeklarimit kryhet në Sistemin e Prokurimit Elektronik.

7. Pavarësisht parashikimeve të pikës 5 të këtij neni, operatorëve ekonomikë të regjistruar në regjistrat tregtarë shqiptarë nuk u kërkohet të paraqesin dokumente mbështetëse ose prova të tjera dokumentare për atë pjesë të informacionit të deklaruar dhe të gjeneruar automatikisht në Sistemin e Prokurimit Elektronik si pjesë e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit nga ndërveprimi me sisteme të tjera elektronike.

8. Operatorët ekonomikë mund të përmbushin kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit edhe nëpërmjet dosjes virtuale të operatorit, e krijuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sisteme të tjera elektronike për ruajtjen e dokumenteve. Dokumentet e dorëzuara si pjesë e dosjes virtuale të operatorit duhet të jenë të gjeneruara nga sisteme të tjera elektronike ose të noterizuara përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Operatorët ekonomikë janë përgjegjës për përditësimin e të dhënave në mënyrë automatike, për aq sa është e mundur, në dosjen virtuale të operatorit.

9. Për operatorët ekonomikë vendas, Sistemi i Prokurimit Elektronik verifikon automatikisht përmes ndërveprimit me sisteme të tjera përmbushjen e kushteve detyruese për skualifikim dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për aq sa është e zbatueshme.

10. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor për operatorët ekonomikë të huaj i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë pranë autoritetit kontraktor në origjinal ose kopje të noterizuar dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike, të cilat nuk mund të gjenerohen automatikisht nga sistemet e tjera me anë të ndërveprimit. Dokumentet e noterizuara para noterëve publikë të Republikës së Shqipërisë dorëzohen online në Sistemin e Prokurimit Elektronik përmes ndërveprimit me sistemin elektronik të Dhomës Kombëtare të Noterisë. Në procedurat e prokurimit me faza, dokumentacioni sipas pikës 5 u kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.

11. Autoriteti ose enti kontraktor do të përdorë sistemin e-Certis për të marrë informacion për llojet dhe format e provave të përmendura në këtë nen dhe për autoritetet kompetente, që i lëshojnë ato në shtetet anëtare të Bashkimit European.”

III.2.5. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. *Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.*

6. *Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

III.2.6. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.2.7. Refruar arsyes së skualifikimit të OE ankimues, pretendimeve të tyre dhe materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur në sistem Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të cilin në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi, autoriteti/enti kontraktor e pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të

kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike, duke i rezervuar në këtë mënyrë të drejtën autoritetit kontraktor të kryejë verifikime në rast nevojë apo të dërgojë kërkesa për sqarim mbi dokumentacionin e paraqitur nga operatorët ekonomikë. Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit 2.3.3/f ka përcaktuar stafin teknik/profesional të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate sikurse paraqitet në pikën III.2.1 të këtij vendimi.

Kriteri i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit, dhe vetëm përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të renditur i pari dorëzimin e dokumentave provuese. Referuar përcaktimit të bërë lidhur me stafin teknik, konstatohet se autoriteti kontraktor ka të drejtë të verifikojë disponueshmërinë e këtij personeli teknik si gjatë vlerësimit të ofertave ashtu edhe gjatë zbatimit të kontratës. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se, për përmbushjen e kriterit të veçantë të kualifikimit 2.3.3/f, për të cilin janë kërkuar 2 (dy) Automaknist, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune/shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratë. OE ankimes ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar, për fazën procedurale ku është procedura e prokurimit. Duke iu referuar arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të ofertave, KPP konstaton se, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur në SPE, “Liqeni VII” SHPK, në Seksionin B: Deklaratë “Për disponimin e punonjësve të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate”: ka deklaruar Z. E. M., me profesion automaknist, i punësuar pranë shoqërisë, në rolin e automaknistit me kontratë pune dhe dëshmi kualifikimi. Z. A. Sh., me profesion automaknist, i punësuar pranë shoqërisë “xxx” Shpk, në rolin e automaknistit për betonierën e marrë me qera pranë shoqërisë “xxx” Shpk, me targa AAxxxxme kontratë midis palëve (Rep.xxxx, Kol xxx, datë 10.12.2025-deri në përfundim të objektit) dhe me dëshmi kualifikimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE ankimes në SPE në përmbushje të këtij kriteri si dhe deklarimeve të bera në FPV në rubrikën përkatëse, Komisioni gjykon se, OE ofertues disponon 2 (dy) automaknistë në një nga format e kërkuara sipas kriterit të hartuara nga ana e autoritetit kontraktor. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës ku referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e punëve/mallrave/shërbimeve është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Gjithashtu, vlen të theksojmë se, autoriteti kontraktor disponon të gjitha elementet e nevojshme procedurale, si garanci, në rast të shkeljes së kontratës, konkretisht neni 83 “Sigurimi i ofertës” i Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenet 36 “Sigurimi i kontratës”, të VKM nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave

të prokurimit publik”, i ndryshuar. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit për përmbushjen e kriterit 2.3.3/f, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm për këtë fazë.

Për sa më sipër, pretendimi i OE ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHPK, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “OB Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” SHPK, i cili nuk përmbush kriteret e vendosura për kualifikim sipas kriterëve të kualifikimit të bërë nga autoriteti kontraktor për punët e ngjashme, në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt bashkimit të operatorëve ekonomikë “OB Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” SHPK, për të cilët paraqet pretendime për skualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët e renditur sipër tij, referuar vlerës ekonomike.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHPK, mbi ofertën e bashkimi i operatorëve ekonomikë “OB Konstruksion” Shpk & “ED Konstruksion” SHPK, nuk do të merren në shqyrtim.

III.4. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “LIS Konstruksion” Shpk &” Viante Konstruksion” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: *“.....mospërputhja e formularit të ofertës me preventivin, si dhe përllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim.....”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 2 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca2.

(Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)

LISTA E ÇMIMEVESIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT

Data: _____

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE): _____

Monedha: _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë zërave në Formularin e listës së çmimeve sipas zërave të preventivit dhe grafikut të realizimit të punimeve duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar për secilin zë në preventiv. Zërat e preventivit pa vlerëdo të konsiderohen si zëra të paofertuar dhe do të çojnë në refuzimin e ofertës.

Oferta ekonomike e detajuar

Nr	Nr. Analizë	Përshkrimi i Punëve	Njësi	Sasia	Çmimi/ Njësi	Cmimi total
1.						
2.						
3.						
Shuma						
Fondi Rezervë						
Shuma						
TVSH						
SHUMA TOTAL						

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula

Shënim: Çmimet duhet të shprehen në Monedhën ____ (e kërkuar në dokumentat e tenderit)

III.4.2. Autoritetit kontraktor ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit në rubrikën “Dokumentat e tenderit” preventiv pa çmime me përmbajtje si më poshtë vijon:

		28. PAJISJE JASHTË LISTE				
440	Pj	Impiant klorifikimi >	copë	1.0		
441	Pj	Cisterne dhe depo PE 80 l >	copë	1.0		
442	Pj	Cisterne dhe depo PE 125 l >	copë	1.0		
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	29.8046 66		
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100.0		
445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244.0		
446	Pj	F.V. Mates Uji Elektromagnetik DN=PN16 >	copë	3.0		
		Shuma 28:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Preventivuesi:
C.E.C GROUP

Investitori:
AKUK

III.4.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se BOE ankimues, në përmbushje të kriterit sa më sipër, kanë dorëzuar:

-Formular i ofertës ekonomike sipas formatit shtojca 1 dhe shtojca 2 të DT;

III.4.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.4.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.4.6. Vendim Nr. 610, Datë 22.9.2022 “Për Përcaktimin E Rregullave Të Detajuara Për Mënyrën E Caktimit Të Mbikëqyrësit, Detyrat Dhe Përgjegjësitë E Tij, Kushtet Dhe Elementet E Përgjithshme Të Sigurimit Të Përgjegjësisë Profesionale, Si Dhe Rregullat, Procedurat Dhe Mënyrën E Mbajtjes Së Dokumentacionit Gjatë Zhvillimit Të Punimeve”, në Shtojcën XII të tij pasqyrohet:

OBJEKTI: “_____”

ZBATUESI I PUNIMEVE: “_____” sh.p.k.

Datë: ____/____/____	Nr.	Nr. i analizës	Emërtimi i punimeve të kryera	Njesia	Sasia e punimeve të kryera	Çmimi	Vlefë
Shuma e analizave							
Fondi rezervë deri në 5%							
(vendoset në situacionin përfundimtar në % e përdorur)							
Shuma (Analiza+fondi rezervë)							
TVSH							
Pajisje							
Totali							

Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”, në nenin 5 të tij parashikon se: *“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit..”.*

Ndërsa në Nenin 6, 7 dhe 18 të tij parashikon :6. *“Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së*

Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim."

7.Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.

18. Të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit, të zbërthyer sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr. 2, datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit".

III.4.7. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*", të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.4.8. Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga ankimesi, konstatohet se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim i pajisjeve me dhe pa TVSH. Tabela e preventivit ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e autoritetit kontraktor është si më poshtë, e cila është edhe arsyeja e skualifikimit të BOE ankimes:

		28. PAJISJE JASHTË LISTE				
440	Pj	Impiant klorifikimi >	copë	1.0		
441	Pj	Cisterne dhe depo PE 80 l >	copë	1.0		
442	Pj	Cisterne dhe depo PE 125 l >	copë	1.0		
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	29.8046 66		
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100.0		
445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244.0		
446	Pj	F.V. Mates Uji Elektromagnetik DN=PN16 >	copë	3.0		
		Shuma 28:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (5.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)						
TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

Preventivuesi:

C.E.C GROUP

Investitori:

AKUK

Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I, Udhëzime për operatorët ekonomikë, gërma B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar [...]*”. Konstatohet se, preventivi i paraqitur nga ana e BOE ankimues është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Në rastin konkret, BOE ankimues ka dorëzuar preventivin të plotësuar sipas rubrikave dhe kërkesave të autoritetit kontraktor. Nisur nga arsyetimi dhe arsyetimit të dhënë në informacionin e dërguar nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, Komisioni i Prokurimit konstaton se, në plotësimin e formularit të ofertës ekonomike nga ana e ofertuesit BOE “Lis Konstruktion” Shpk & “Viante Konstruktion” Shpk sipas formatit shtojca 1 dhe shtojca 2 e DT:

28. PAJISJE JASHTË LISTE					
440	Pj	Implant klorifikimi >	copë	1,0	
441	Pj	Cisterne dhe depo PE 80 l >	copë	1,0	
442	Pj	Cisterne dhe depo PE 125 l >	copë	1,0	
443	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 1-lidhje >	copë	30,0	
444	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 2-lidhje >	copë	100,0	
445	Pj	Mates uji 1/2", Q=2.5 m3 /h 4-lidhje >	copë	244,0	
446	Pj	F.V. Mates Uji Elektromagnetik DN=PN16 >	copë	3,0	
Shuma 28:					
Shuma Analiza					
Fondi Rezervë (5.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)					
TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)					
Shuma TVSH (për pajisje)					
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)					
Totali					
BOE: "LIS KONSTRUKSION" SHPK & " VIANTE KONSTRUKSION" SHPK					

Së pari, BOE ankimues ka plotësuar në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar dhe hartuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Së dyti, në kapitullin e preventivit “28. Pajisje jashtë liste”, konkretisht zërat Pajisje, ofertuesi ka dhënë çmimin pa tvsh për njësi/copë * sasia /copë = X vlera/çmimi total lekë pa tvsh për çdo zë të pajisjeve. Pra, për sa i përket strukturës së preventivit, referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe Manualit të Përdorimit të këtij sistemi në e-albania, për pajisje jashtë liste, sistemi jep dy alternativa (0% ose 20%), ndërsa për pajisje nga lista aplikohet automatikisht 20%. Për këtë arsye, preventivi i hartuar nga projektuesi, duhet të ishte më i qartë dhe i shoqëruar me sqarime të detajuara duke vënë në dijeni edhe autoritetin kontraktor, se cilin konfigurim ka zgjedhur projektuesi për pajisjet jashtë liste.

III.4.7. Megjithatë, në rastin konkret, për një shqyrtim të drejtë të pretendimit të BOE ankimues nga njëra anë si edhe parashtrimeve të autoritetit kontraktor nga ana tjetër, KPP gjykon të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve të sipërcituar, mbi gabime të mundshme në përlllogaritjen e ofertës ekonomike si vlerë totale e kërkuar pa shtuar Tatimin mbi Vlerën e Shtuar për kryerjen e punimeve në total. Referuar tabelës përmbledhëse të formularit të ofertës, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi, Punime Elektrike, Punime Instalimi (Hidrosanitatë, ngrohje, mbr nga zjarri), punime montimi paisje, si edhe furnizim i paisjeve me TVSH. Në pikën 3 “Modalitetet dhe mënyra e e zbatimit të TVSH-së në ndërtim të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, paragrafët 1,4 parashikohet se: “Kur një person i tatueshëm, shoqëri ndërtimi kryen punime ndërtimi të çdo lloji për punë private ose publike, punime në të cilat përveç vlerës së punës përfshihet edhe vlera e materialeve të përdorura, punime rikonstruksioni, restaurimi të një objekti ose ndërton një objekt (ndërtesë) të re, ose kryen punime që kanë të bëjnë me punë publike

(rrugë, rregullim terrenesh, etj), është i detyruar që çdo muaj të situacionojë punimet e kryera nëpërmjet një situacioni analitik ku të tregojë të gjitha zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura në sasi e vlerë dhe çdo element tjetër punimesh të përfshirë në situacionin e punimeve, përfshirë edhe tatimet apo taksat apo detyrime të tjera që llogariten dhe përfshihen në vlerën e tatueshme të punimeve të kryera, përveç TVSH-së. Bazuar në nenin 99, pika 5 të ligjit fatura në ndërtim lëshohet çdo muaj. Çdo situacioni mujor të punimeve të kryera i bashkëngjitet detyrimisht fatura tatimore me numër serial.TVSH-ja llogaritet dhe paguhet çdo muaj mbi vlerën e situacionit mujor të punimeve, e cila është edhe vlera e tatueshme mbi të cilën do të llogaritet TVSH-ja në masën 20%. Gjithashtu çdo person i tatueshëm që kryen punime të pjesshme në ndërtimin e një objekti si p.sh. punimet elektrike të objektit është i detyruar të tregojë në faturë zërat e punimeve të kryera, materialet e përdorura dhe vlerat përkatëse për çdo zë më vete. Vlera e çdo situacioni mujor të shoqëruar me faturën tatimore me TVSH regjistrohet në librin e shitjeve dhe deklarohet në deklaratën e TVSH-së të periudhës që i përket. Në rastin kur ndërtohet një objekt prej një personi të tatueshëm që ndërton sipas porosisë së një personi tjetër të tatueshëm, një objekt për qëllime të kryerjes së veprimtarisë ekonomike së tij ekonomike, mund të ndeshemi me dy situata: a) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm; b) Objekti që do të ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm. Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do ti shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë:Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbresë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit. Përsa i përket pikës 4, rasti b), ku objekti që ndërtohet do t'i shërbejë veprimtarisë ekonomike të tatueshme të personit të tatueshëm, për shembull ndërtohet një magazinë që personi i tatueshëm e përdor për magazinimin e mallrave për t'u shitur, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të tatueshme, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, i lind e drejta e zbritjes së TVSH-në së paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim do të përdoret për një veprimtari të tatueshme me TVSH, për pasojë bazuar në parimin e neutralitetit të TVSH-së do t'i shërbejë një veprimtarie nga e cila lindin pagesa të TVSH-së.”

III.4.8. Në rastin konkret, KPP gjykon se, në cilësinë e personit të tatueshëm ndërtues, BOE ankimues ka përllogaritur koston ekonomike të ofertës së tij duke përfshirë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga kuadri ligjor në fuqi dhe veçanërisht detyrimet dhe rregullimet e kreditimit/zbritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar. Në rastin konkret, nga ana e tatimpaguesit investitor është propozuar rikonstruksion i një objekti (furnizimi me ujë) që do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm, Referuar paragrafit 4 gërma “a” të pikës 3 “Modalitetet dhe mënyra e e zbatimit të TVSH-së në ndërtim të Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH”, parashikohet se “Përsa i përket pikës 4, rasti a), ku objekti që ndërtohet do të shërbejë veprimtarisë ekonomike të përjashtuar të personit të tatueshëm. Për shembull ndërtohet një bankë, ose një shkollë, ose një spital, atëherë: Personi i tatueshëm ndërtues situacionon dhe i lëshon faturën tatimore personit të tatueshëm investitor të objektit, për punimet e kryera për çdo muaj duke llogaritur dhe paguar TVSH-në, pasi ka zbritur TVSH-në që ka rënduar blerjet e kryera prej tij për këtë qëllim. Nga ana e tij, personit të tatueshëm investitor të objektit, i cili do ta përdorë objektin e ndërtuar për veprimtarinë e tij të përjashtuar nga TVSH-ja, bazuar në rregullat e zbritshmërisë së TVSH-së të parashikuara në kapitullin X të ligjit, nuk i lind e drejta të zbrësë TVSH-në e paguar personit të tatueshëm ndërtues për punimet e ndërtimit pasi ky investim, këto punime të kryera bazuar edhe në parimin e neutralitetit të TVSH-së do të përdoren dhe do t'i shërbejnë një veprimtarie, nga e cila nuk lindin pagesa të TVSH-së, përse kemi të bëjmë me veprimtari të përjashtuar nga TVSH-ja sipas ligjit.”

Në rastin konkret, KPP gjykon se, në përllogaritjen e vlerës ekonomike BOE ankimues ka parashikuar vlerën totale të punimeve pa TVSH dhe vlerën totale të punimeve me TVSH. Në respekt të udhëzimit të sipërcituar, autoriteti kontraktor, në cilësinë e tatimpaguesit investitor ka parashikuar në formularin e ofertës se për kapitullin “Pajisje jashtë liste” nuk tatóhet dy herë në total me Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për sa kohë që, pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor ofertohen me vlerën e tyre, konkretisht çmimin pa tvsh për njësi/copë * sasia /copë = X vlere/çmimi total lekë pa tvsh për çdo zë të pajisjeve, sipas strukturës së preventivit të zgjedhur nga projektuesi dhe të miratuar dhe publikuar nga vetë autoriteti kontraktor, i cili nuk ka dhënë asnjë sqarim përkatës në lidhje me metodologjinë e plotësimit, rezultojnë që, zërat e pajisjeve jashtë liste për kapitullin “28. Pajisje jashtë liste”, nuk kanë të përfshirë në çmimin për njësi, vlerën mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Në përfundim, nga përllogaritjet e veprimeve aritmetike të formularit të ofertës ekonomike të BOE ankimues, Komisioni konkludon se, plotësimi i saj është bërë sipas strukturës së preventivit të shtojcës 2 të DT dhe në përputhje të plotë me aktet nënligjore në fuqi referuar Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” si dhe Manualit të Përdorimit të këtij sistemi në e-albania. Atëherë, në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlere totale e tyre e pajisjeve (bashkë me TVSH) do të shtohen në përfundim totalit të propozuar të ofertës ekonomike me TVSH. Sa më sipër, KPP gjykon se në përllogaritjen e vlerës totale të ofertës ekonomike, BOE ankimues, ka plotësuar të gjitha rubrikat e vendosura në hartimin e strukturës së preventivit, si dhe nga kontrolli i veprimeve matematikore, Komisionit konstaton se, nuk jemi në rastin e ndonjë

gabimi aritmetik qoftë në shumëzimin apo edhe në mbledhjen aritmetike të vlerave financiare apo në aplikim dy herë të Tvsh për pajisjet jashtë liste. Pra, referuar edhe mënyrës së plotësimit të të gjithë rubrikave të preventivit si dhe vlerave financiare të ofertës ekonomike nga ana ofertuesit ankimues, është konform asaj të kërkuar nga ana e AK dhe brenda kuadrit ligjor të përlllogaritje së vlerës mbi Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Për më tepër, referuar edhe argumentimit të bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, duke marrë si referencë një vendim të KPP_së, i cili daton në vitin 2022, vit i cili akoma nuk ishte implementuar sistemi i informatizimit të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim, si dhe hartimi në e-albania të preventivit nga projektuesi, i cili bie ndesh me kuadrin ligjor të përditësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE). Sa më sipër, KPP gjykon se, në përgatitjen e ofertës ekonomike nga ana e BOE ankimues pretendimi i mësipërm i autoritetit kontraktor nuk përfshihet në rastet e konstatimit të gabimit aritmetik, por njëherazi në përlllogaritjen e ofertës nga ana e ankimuesit nuk shfaqen gabime në drejtim të ndërtimit të ofertës ekonomike dhe vlerës totale të saj me dhe pa TVSH duke mos rënë ndesh me parashikimet dhe rregullimet e posaçme ligjore në legjislacionin sektorial tatimor. Në përfundim të analizës së sipërcituar, autoriteti kontraktor duhet të kthejë procedurën e prokurimit në fazë të rivlerësimit dhe të kryejë rivlerësim të ofertës ekonomike të BOE ankimues, duke i reflektuar këto veprime me anë të dokumentacionit përkatës nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “*LIS Konstruksion*” Shpk &” Viante Konstruksion” Shpk, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “.....*Nuk ploteson kriterin mbi autorizimet , kataloget e saraqinesave dhe rakorderive jane ne gjuhe te huaj jo shqip gje e cila bie ne kundeshitim me dokumentacionin e tenderit pika me piken 4.7 ne dokumentat standarte te tenderit ku percaktohet se : 4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat: Shqip X Anglisht Komisioni i vleresimit te ofertave per sa me siper gjykon dhe analizon se BOE LIS KONSTRUKSION shpk& Viante Konstruksion shpk ka mungese dokumentacioni dhe shkelje te kriterëve te hartuara ne DST per kete arsye skualifikohet.....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ Tuba Ujësjiellësi PE
- ✓ Tuba Korrogato/Brinjezuar PVC
- ✓ Rakorderi
- ✓ Saraqineska Gize
- ✓ Matsa uji

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- *Autorizim të Prodhuesit/ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi/Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.*
- *Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve e prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut /ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.*
 - ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE dhe Rakorderi** të paraqitet certifikatë aprovimi nga një Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që verteton që tubat dhe rakorderit janë përdorimin në sistemet e ujit të pijshëm.
 - ✓ **Tuba Korrogato/Brinjezuar (KUZ)** të paraqitet certifikatë aprovimi nga një Insitucion Institucion Ndërkombëtar ose Kombëtar, i Akredituar që tubat janë për perdorim kanalizime nëntokesore.
 - ✓ **Saraqineska Gize**, të paraqitet Certitifikatë Kalibrimi Sipas Direktivave të Enteve nën Presion.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtoria.

III.5.2. Nga dokumentat standarde të tenderti pika 4.7:

4.7 Gjuha (ët) në të cilat mund të hartohen ofertat:

Shqip	X	Anglisht	☐
--------------	----------	-----------------	--------------------------

III.5.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se bashkimi i operatorëve ekonomikë “Lis Konstruktion” Shpk dhe “Viante Konstruktion” Shpk, në përmbushje të kriterëve sa më sipër, ka dorëzuar:

- Autorizim prodhuesi për secili artikull të kërkuara janë të përkthyer dhe noterizuar;
- Katalog për rakoderitë nga prodhuesi Pestan-janë në gjuhë angleze;
- Katalog për tubat- nga prodhuesi Ferplas, Kosove, në gjuhën shqipe të përkthyer dhe noterizuar;
- Katalog për saracineska nga prodhuesi Turhan, Turqi, janë në gjuhë angleze;
- Katalog për sahalet nga prodhuesi Enelean, Turqi, janë në gjuhë angleze;

III.5.4. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.5. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme”: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.5.6. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e

dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt - prokurimi

III.5.7. Nisur nga arsyet e skualifikimit, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë në SPE, të cituar edhe në pikën III.5.3. të këtij vendimi, konstatoi se katalogët e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik nuk janë të përkthyer në gjuhën shqip. Nisur nga pretendimi i BOE për kundërshtimin e skualifikimit me arsyetimin se: *“.....kataloget e saraqinesave dhe rakorderive jane ne gjuhe te huaj jo shqip gje e cila bie ne kundeshtim me dokumentacionin e tenderit pika me piken 4.7 ne dokumentat standarte te tenderit...”,* si dhe referuar dokumentave të tenderit, Komisioni thekson se, procedura e prokurimit objekt ankimi është “Procedurë e hapur”. Referuar pikës 2 të neni 24 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar ku parashikohet shprehimisht se: *“2. Në rastin e procedurave të prokurimit mbi kufijtë e lartë monetarë, dokumentet e tenderit duhet të hartohen në gjuhët shqip dhe anglisht. Operatorët ekonomikë mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht. Në procedurat e prokurimit nën kufijtë e lartë monetarë, gjuha e përdorur është gjuha shqipe. Në këto procedura, në raste specifike, nëse autoriteti/enti kontraktor e gjykon të nevojshme, mund të hartojë dokumentet e tenderit në gjuhët shqip dhe anglisht dhe njofton operatorët ekonomikë se mund të paraqesin ofertat e tyre në gjuhët shqip ose anglisht.”,* në këto kushte Komisioni gjykon se, duke qenë se procedura e prokurimit objekt ankimi është procedurë nën kufirin e lartë monetar, ligjvënësi ka përcaktuar se gjuha e prokurimit e përdorur është gjuha shqip dhe rrjedhimisht dhe oferta e dorëzuar duhet ti përmbahet gjuhës së prokurimit. Sqarojmë, se përkufizimi ligjor i mësipërm është gjithpërfshirës, pra për të gjithë dokumentacionin përkatës, që paraqitet në këtë procedurë prokurimi. Në kushtet kur, në dokumentet e tenderit të hartuara e të miratuara nga Agjencia e Prokurimit Publik, e konkretisht në kriteret e përgjithshme të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë, si dhe nuk duhet të ndryshohen për asnjë arsye nga autoriteti kontraktor gjatë hartimit të dokumenteve të tenderit, është përcaktuar qartësisht se *“Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe”* në këtë kuadër, i gjithë dokumentacioni i paraqitur në procedurën e prokurimit në sistem elektronik duhet të jetë në gjuhën shqipe ose i shoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Gjithashtu, duke u referuar në DST e procedurës objekt-ankimi, konkretisht në kreun “Udhëzime për operatorët ekonomikë” Seksioni 1, “B Përgatitja e ofertave” pika 2 ‘Gjuha e ofertës’ ku përcaktohet se: Oferta, si dhe të gjitha korrespondencat dhe dokumentet në lidhje me procedurën e prokurimit do të paraqiten në gjuhën/gjuhët e specifikuar në njoftimin e kontratës. Dokumentet mbështetëse dhe literatura e printuar që janë pjesë e Ofertës mund të jenë në një gjuhë tjetër me kusht që ato të shoqërohen nga një përkthim zyrtar i fragmenteve përkatëse në gjuhën e specifikuar në njoftim”, duhet që të gjithë dokumentet e paraqitura në rrugë elektronike të jenë në gjuhën shqipe siç autoriteti kontraktor

ka përcaktuar në njoftimin e kontratës ose nëse janë në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastin konkret në sistemin e prokurimit elektronik, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur, në gjuhë të huaj, katalogët e sipërcituar dhe të pashoqëruar me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe në kundërshtim me atë që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në përmbajtjen e dokumenteve të tenderit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente do të refuzohen si të papranueshme. Në këtë kuadër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se nga ana e ankimuesit nuk janë përmbushur të gjitha kërkesat që autoriteti kontraktor ka përcaktuar në dokumentet e tenderit, duke dorëzuar dokumente në gjuhë të huaj të pashoqëruara me përkthim të noterizuar, një kusht ky i detyrueshëm për ankimuesin, pasi ai duhet të plotësojë çdo kërkesë dhe kriter të vendosur nga autoriteti kontraktor, si dhe të paraqesë çdo dokumentacion, që përmban të dhëna dhe elemente që janë gjykuar të nevojshme dhe të domosdoshme nga ana e këtij të fundit. Në këto kushte sa më sipër arsyetuar, Komisioni gjykon se, pretendimi i bashkimit të operatorëve ekonomik nuk qëndron, pasi dokumentacioni i dorëzuar duhet të ishte përkthyer në gjuhën shqip në përputhje me parashikimet e rregullave të prokurimit publik.

Sa më sipër pretendimi i BOE nuk nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 *“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e OE ankimues “Liqeni VII” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastrë”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e BOE ankimues “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”, për procedurën e “E hapur”, me REF-68208-11-10-2025, me objekt: “Furnizimi me ujë për fshatrat Picar & Kolonjë të Bashkisë Gjirokastrë”, me fond limit 129,188,262.00 lekë (pa tvsh), zhvilluar në datë 11.12.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Gjirokastrë Sh.a.

3. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Liqeni VII” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.
 4. Autoriteti kontraktor të rishikojë arsyet e skualifikimit të BOE ankimues “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk” dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër.
 5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi duke dokumentuar veprimet e kryera.
 6. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Liqeni VII” SHPK.
 7. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “Lis Konstruksion Shpk & “Viante Konstruksion Shpk”.
 8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 9. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

